



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____/2023

Datë: 27.07.2023

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 15 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01 nr011/04-29365 i datës 30.12.2022, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.07.2023 pas diskutimit lidhur me pikën e 10 të rendit të ditës: Propozim-vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme Komunale Parkingu në parcelën me nr. P-70705029-00468-24, e miratoi këtë:

VENDIM

- Formohet Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme Komunale Parkingu në parcelën me nr. P-70705029-00468-24, me këtë përbërje:
 - z. Shkumbim Kastrati, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës .
 - znj. Adelina Shehu Kola, përfaqësuese nga Ekzekutivi i Komunës.
 - z. Bashkim Gashaj, përfaqësues i Kuvendit të Komunës .
 - z. Ali Tafarshiku, përfaqësues i Kuvendit të Komunës .
 - znj. Brilanda Ballata, përfaqësuese e sektorit jo qeveritar .
- Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi që ti zhvilloj procedurat e parapara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale për pronën e cekura në pikën 1 të këtij vendimi për të cilin është nxjerrë vendimi paraprak nga Kuvendi i Komunës.
- Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .
- Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës.
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Anëtareve të Komisioni Vlerësues.
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit .

Arbëneshë Kuqi
Kryesuesja e Kuvendit të Komunës